KOMUNA E LIPJANIT

BULETINI MUJOR

SHTATOR 2020

KOMUNA E LIPJANIT PËR TË TRETËN HERË RADHAZI ËSHTË ZGJEDHUR NGA USAID E PARA NË PËRFORMANCË MË TË MIRË NË "INDEXIN E KONKURRUESHMËRISE SË KOMUNAVE PËR VITIN 2020"





Është viti i tretë i vlersuar sipas parametrave matës që në indeksin e konkurueshmerisë së Komunave në Kosovë, Komuna e Lipjanit ka treguesit më pozitiv me trende stabile pozitive në fushat e matjes në këtë indeks.

https://kk.rks-gov.net/lipjan/
0 800 14 000

Kryeministri Avdullah Hoti dhe Kryetari Imri Ahmeti përuruan shkollë e re në Magure

Ditën e parë të vitit të ri shkollor 2020/2021 nxënësit e Magures e kanë nisur në shkollë të re. Kryetari i komunës Imri Ahmeti falënderoj Kryeministin Hoti për ndihmën e dhënë në ndërtimin e kësaj shkolle.

Edhe një shkollë e renovuar në tërsi ka filluar punën këtë vit të ri shkollor

Kryetari i Komunës Imri Ahmeti me bashkëpunëtorët ka vizituar shkollën e mesme profesionale "Adem Gllavica", në Lipjan, shkollë kjo e cila është renovuar në tërsi me financim nga Departamenti i Ushtrisë Amerikane në Evropë.

Shkolla e fshatit Babush e rinovuar tërësisht

Kryetari i Komunës Imri Ahmeti me bashkëpunëtorët e tij ka vizituar sh.f.m.u "Ernest Koliqi", në Babush, për të parë nga afër kushtet dhe përgatitjet e bëra pas renovimit të tërësishëm qe ju është bërë kësaj shkolle.

Përurohet shkolla fillore në fshatin Rubovc

Biblioteka e qytetit është pasuruar me 109 tituj të rinjë

NGJARJE TË TJERA

- Përurohet shkolla fillore në fshatin Rubovc
- Kryeministri Avdullah Hoti dhe Kryetari Imri Ahmeti përuruan shkollë e re në Magure
- Komuna e Lipjanit për të tretën herë radhazi është zgjedhur nga USAID e PARA në përformancë më të mirë në “Indexin e Konkurrueshmërise së Komunave për Vitin 2020
- Edhe një shkollë e renovuar në tërsi ka filluar punën këtë vit të ri shkollor
- Së shpejti fillon renovimi i ndërtesave shumë banesore në qytetin e Lipjanit
- Shkolla e fshatit Babush e rinovuar tërësisht
- Po vazhdon asfaltimi i rrugëve në Gadime
- Kryetari Imri Ahmeti ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi për mbështetjen e shkollës “Adem Gllavica” nga projekti ESVET PRO
- Shpërndahen pako didaktike të dhuruara nga UNICEF.
- Kryetari Imri Ahmeti ka pritur humanisten Elizabeth Gowing
- Po Vazhdon shpërndaja e çantave shkollore në Komunën e Lipjanit

Po vazhdon asfaltimi i rrugëve në Gadime

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Akllap

Lipjani me shtigje funksionale faza parë. Do vazhdohet edhe 2,7 km në fazën e dytë për të krijuar hapësirë dhe mundësi për rekreacion qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Përurohet salla e sportit në Kraishtë

Kryetari Imri Ahmeti dhe Ministri Arban Abrashi përcjellin punimet tek rreth rrotullimi në rrugën nacionale, N2 Prishtinë-Ferizaj

Kryetari Ahmeti prezantoi raportin gjashtëmujor të punës

“Padyshim viti 2020 është ndër vitet ma sfiduese të qeverisjes lokale dhe para nesh vjen edhe me tutje sfida më shumë të panjohura me pandeminë covid-19. Ne duhet të jemi koshient për vështirësitë në realizimin e planit, në veçanti të të hyrave vetanake të planifikuara, në realizimin e planit të shpenzimeve të parapara buxhetore, sepse impakti i kufizimit të ativiteteve të bizneseve, pakoja emergjente dhe përgjithësishtë efektet e pandemisë covid-19 do të reflektojnë në mungesë të realizimit të agjendës së paraparë buxhetore”, është shprehur Kryetari Imri Ahmeti.

Komuna e Lipjanit për të tretin vit me radhë vlerësohet nga Zyra Kombëtare e Auditimit me OPINIONIN e PAMODIFIKUAR

Opinioni i pamodifikuar është opinioni më i mirë në mesin e katër lloje të opinioneve që jep zyra kombëtare e auditorit lidhur me shpenzimin e buxhetit të komunës.

KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT, IMRI AHMETI SOT ËSHTË ZGJEDHUR KRYETAR I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

Kryeministri Hoti e vlerëson lartë qeverisjen lokale me vëmendje të veçantë zhvillimet pozitive në komunën tonë

Përfaqësues nga Komuna e Lipjanit kanë nderuar dëshmorin e Kombit Arsim Zeqiri

QMF në Shalë është e pajisur me pajisjet adekuate të teknologjisë mjekësore për punë, defibrilator automatik që ju shërben pacienteve

Drejtorati për Planifikim dhe Urbanizëm ka mbajtur 4 takime me qytetarë për prezantimin e projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Lipajnit 2020-2028

"Me Harta Zonale nuk do të këtë më degradime të ndërtimeve dhe asnjë objekt banesor nuk do të lejohet të ndërtohet pa i plotësuar të gjitha kriteret duke u nisur nga distanca ndërmjet tyre, hapësira e rrugës me qëllim të hyrjes së zjarrfikësve në raste të zjarreve, hapësirat gjelbëruese dhe një varg kriteresh të tjera" tha drejtoresha Emina Rexhiq.



Kryetari Imri Ahmeti ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi për mbështetjen e shkollës “Adem Gllavica” nga projekti ESVET PRO e cila financohet nga Bashkimi Europian

Kryetari Imri Ahmeti ka pritur humanisten Elizabeth Gowing

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti me bashkëpunëtorët e tij, ka takuar Elizabeth Gowing, përfaqësuese e organizatës The Ideas Partnership së bashku me koordinatoren e qendrës në Janjevë Majlinda Krasniqi.

KOMUNA E LIPJANIT

- Aprovohet buxheti për vitin 2021-2023
- Miratohet rregullorja për menaxhim të mbeturinave në Komunën e Lipjanit

BUXHETI 2021

16,719,155.00 EURO

9,574,000.00 EURO, PAGA

1,700,000.00 EURO, MALLRA DHE SHËRBIME

280,000.00 EURO, SHËRBIME KOMUNALE

500,000.00 EURO SUBVENCIONE

4,665,155.00 EURO INVESTIME KAPITALE

KOMUNA E LIPJANIT

COVID-19

Komuna e Lipjanit ka mengjuar situaten me pandemi ku deri me daten 29.09.2020 jane identifikuar këto raste:

385	48	323	14
TOTAL	AKTIVE	TË SHËRUAR	TË VDEKUR



KY BULETIN ËSHTË PËRGATITUR NGA ZYRA PËR INFORMIM